



**VENDIM**

**Nr. 124 Datë 28.10.2013**

**PËR**

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ”  
SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE  
NGA HEC-ET “QARR” DHE ”KALTANJ”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, 5pika 1 gërma “a” dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et “Qarr” me fuqi të instaluar 1 Mw dhe “Kaltanj” me fuqi të instaluar 0,5 Mw.”
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**